



OSBE Misioni në Kosovë Të dhëna për Misionin

2009

Misioni i OSBE-së promovon të drejtat e njeriut dhe mirëqenie për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë duke monitoruar dhe mbështetur punën e institucioneve vendore. Ky është Misioni më i madh i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, OSBE, i themeluar më 1999.

Në pajtim me mandatin e tij, Misioni ka ndihmuar krijimin dhe zhvillimin e institucioneve që i mundësojnë Kosovës të funksionojë si shoqëri demokratike. Këtë më së miri e ilustron puna e bërë me Kuvendin e Kosovës, administratat komunale, Ombudspersonin, institutin gjyqësor, transmetuesin publik, rregullatorët e mediave, shkollën policore dhe inspektoratin policor. Misioni edhe më tutje vazhdon të mbështesë dhe forcojë këto institucione duke trajnuar dhe ndihmuar zyrtarët publik dhe duke monitoruar punën e tyre për pajtueshmëri me standardet e të drejtave të njeriut dhe parimet e qeverisjes së mirë.

Duke mos paragjykuar statusin e Kosovës, çdo individ duhet të jetë i barabartë para institucioneve funksionale, që respektojnë të drejtat e njeriut dhe që u përmbahen praktikave të qeverisjes së mirë. Misioni promovon respekt reciprok dhe tolerancë ndërmjet komuniteteve si dhe ndihmon formimin e shoqërisë së shëndoshë shumetnike.

Reduktimi i Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ka shtuar rëndësinë e prezencës së OSBE-së, posaçërisht në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Misioni është shndërruar në "sy dhe veshë" të bashkësisë ndërkombëtare, me staf të pranishëm në secilën komunë, shumicën e ministrive, Kuvendin e Kosovës dhe në një numër të institucioneve të pavarura publike. Ekipet komunale të OSBE-së dhe njësitë e specializuara që kanë të bëjnë me pronën, qeverisjen e mirë, komunitetet, çështjet gjyqësore dhe ato të policisë e informojnë bashkësinë ndërkombëtare për zhvillimet konkrete në këto fusha dhe ndihmojnë atë në arritjen e rezultateve pozitive.

Pas gati dhjetë vite pune, Misioni ka krijuar reputacionin për përgjegjësi dhe profesionalizëm, si dhe ka zhvilluar marrëdhënie të mira pune me të gjitha komunitetet dhe autoritetet lokale.

Aktivitetet

Misioni i OSBE-së është i angazhuar në tri fusha kryesore: të drejta të njeriut, demokratizim dhe siguri publike. Punon me autoritetet qendrore dhe komunale, si dhe me institucione të pavarura në secilën prej këtyre fushave. Gjithashtu, monitoron punën e institucioneve dhe ofron këshilla për përmirësimin e performancës së tyre dhe për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.



Mbrojtja e të drejtave të njeriut

Për të siguruar mbrojtje institucionale dhe afatgjate, Misioni i OSBE-së mbështet institucionin e Ombudspersonit, i cili shërben si monitorues dhe mbështetës publik i të drejtave të njeriut. Këshilltari i Misionit ndihmon punën e përditshme të Ombudspersonit, dhe ndihmon në ngritjen e vetëdijes publike për shërbimet e ofruara nga ky institucion. Misioni gjithashtu ndihmon Institutin Gjyqësor të Kosovës në shkollimin e vazhdueshëm ligjor të gjyqtarëve dhe prokurorëve vendorë, me fokus të veçantë në të drejtat e njeriut.

OSBE-ja ka ndihmuar në themelimin e njësive për të drejtat e njeriut në të gjitha ministrinë dhe komunat e Kosovës dhe ende vazhdon t'i ndihmojë ato me këshilla. Roli i tyre është që të sigurojnë se vendimet e organeve ekzekutive janë në pajtim me të drejtat e njeriut.

Në përpjekje të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në një fazë të hershme, Misioni rishikon projektligjet dhe aktet nënligjore që të jenë në pajtueshmëri me të drejtat e njeriut. Pjesë e këtij procesi janë njësitë për të drejtat e njeriut si dhe komisionet parlamentare për të drejtat e njeriut, çështje gjinore, persona të zhdukur dhe peticione, që gjithashtu mbështeten nga Misioni.

Misioni është një faktor kyç ndërkombëtar në monitorimin e gjyqësorit në Kosovë. Gjatë dhjetë viteve të fundit, monitoruesit e sistemit ligjor të OSBE-së kanë monitoruar punën e gjyqeve penale dhe civile për pajtueshmëri me të drejtat e njeriut. Misioni publikon raporte tematike që përmbajnë rekomandime konkrete për përmirësimin e procedurave gjyqësore dhe ndihmon ato që të jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare. Raportet shkëmbehen me sistemin gjyqësor të Kosovës dhe përdoren për të zhvilluar trajnime të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Misioni gjithashtu monitoron punën e policisë për pajtueshmëri me të drejtat e njeriut. Së fundi, policia ka filluar renovimin e qelive për të paraburgosurit si përgjigje ndaj raportit të Misionit mbi të drejtat e personave të arrestuar.

Misioni i kushton vëmendje të posaçme të drejtave të komunitetit dhe të pronës si dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Fokusohet në qasje në shërbime publike, duke përfshirë shëndetin dhe shkollimin, përdorimin e gjuhëve të huaja dhe kthimin e pronës. Struktura e misionit në teren me pesë qendra rajonale dhe 33 ekipe komunale e bënë atë të veçantë në këtë drejtim. Misioni angazhohet në vazhdimësi për respektimin e të drejtave të komuniteteve, prandaj në fillim të vitit 2008 ka themeluar ekipet komunale në çdo qendër rajonale. Këto ekipe shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe lehtësojnë dialogun në mes të autoriteteve dhe komuniteteve etnike. Dialogu i mbështetur nga Misioni u mundësoi fëmijëve nga komuniteti goran që jetojnë në Dragash të vazhdojnë shkollimin në gjuhën serbe. Në Prishtinë, Misioni ka vendosur dialog me kryetarin e komunës për të parandaluar shkatërrimin e hotelit Union, një nga objektet e pakta të "stilit eklektik" me një vlerë historike, duke mbrojtur trashëgiminë kulturore të kryeqytetit.

Kosova është një vend i origjinës, transitit dhe destinacionit të viktimave të trafikimit, me një shkallë në rritje të trafikimit të brendshëm. Prandaj, misioni i OSBE-së mbështet luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe ndihmon mbrojtjen e viktimave dhe ri-integrimin e tyre. Misioni i tërhoqi vëmendjen Qeverisë së Kosovës për mungesën e fondeve për strehimin e viktimave të trafikimit, veprim ky që shpui në financimin dhe funksionimin e vazhdueshëm të strehimoreve. Misioni gjithashtu ka organizuar fushata të informimit publik dhe një rok koncert me qëllim të vetëdijesimit të të rinjve në lidhje me rrezikun e trafikimit me qenie njerëzore.

Demokratizimi dhe qeverisja e mirë

Ndërtimi i institucioneve dhe zhvillimi i tyre i mëtejshëm demokratik është fusha kryesore e mandatit të OSBE-së. Misioni fokusohet në monitorimin e punës së institucioneve, duke identifikuar mangësitë dhe duke këshilluar si të tejkalohen ato.



Misioni i OSBE-së ndihmon Kuvendin e Kosovës që të shtoj rolin e tij mbikëqyrës mbi ekzekutivin dhe mbështet atë në komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët. Si rezultat i raporteve monitoruese të punës së Kuvendit nga Misioni, përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës kanë rritur prezencën e tyre në sesione dhe u përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit në periudha të rregullta, të caktuara për pyetje dhe përgjigje. Me përkrahjen e Misionit, Kuvendi ka hapur zyra të kontaktit me votues në dhjetë komuna dhe ka krijuar një praktikë të rregullt të vizitave nëpër komuna dhe mbajtjes së takimeve publike gjatë ngjarjes vjetore “Java e Kuvendit”. Kuvendi gjithashtu është nikoqir i “ditëve të hapura të kuvendit” për qytetarë.

Misioni gjithashtu ndihmon komisionet e Kuvendit në rishikimin e projektligjeve për pajtueshmëri me standardet e të drejtave të njeriut dhe shqyrtimin e fondeve të kërkuara për zbatimin e tyre. Për të ndihmuar mbrojtjen e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, Misioni gjithashtu i këshillon grupet parlamentare për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet.

OSBE-ja ka ndihmuar themelimin dhe vazhdon të mbështesë institucionet e pavarura që i raportojnë Kuvendit të Kosovës si: Agjencinë Antikorrupsion, Bordin e Brendshëm Mbikëqyrës, Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Sekretariatit e Komisionit Qëndror Zgjedhor. Pavarësia politike dhe financiare nga ekzekutivi është fundamentale për funksionimin e tyre. Misioni këshillon Qeverinë mbi atë se si të mbajë relacionet e punës me institucionet e pavarura pa rrezikuar integritetin apo pavarësinë e tyre.

Në mes të viteve 2000 dhe 2004, Misioni i OSBE-së ka organizuar katër palë zgjedhje dhe ka themeluar institucionet vendore të zgjedhjeve. Ka siguruar mbështetje teknike për zgjedhjet qendrore dhe lokale të nëntorit 2007. Misioni vazhdon të përkrah dhe këshillojë Sekretariatit e Komisionit Qëndror Zgjedhor, si organ ekzekutiv i komisionit. Misioni u ndihmon partive politike që ta zhvillojnë demokracinë e brendshme dhe platforma të profilizuara dhe të shtoj pjesëmarrjen e grave dhe rinisë në vendimarrje.

Në nivelin komunal, përmes pranisë së përhershme të ekipeve komunale në teren, Misioni monitoron dhe mbështet punën e autoriteteve vendore. Qëllimi i tij është që t'i përmirësojë shërbimet e qytetarëve dhe të mundësojë reformën e qeverisjes lokale në pajtim me kartën evropiane të vetë-qeverisjes lokale. Forumet udhëheqëse komunale të formuara nga Misioni i OSBE-së sigurojnë dialog të mirëfilltë në mes të autoriteteve qendrore dhe lokale për trajnimin e stafit komunal, planifikimin buxhetor dhe financat. Misioni gjithashtu është duke u ndihmuar komunave ta shtojnë transparencën e tyre. Në një përpjekje të tillë, Misioni ka sponsoruar një varg debatesh televizive që kanë hetuar funksionimin e komunave dhe performancën e kryetarëve të komunave të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejt. Këto debate ishin programet televizive më të popullarizuara politike në Kosovë.

Meqë mediet e lira dhe profesionale kanë një rol themelor në shoqëritë demokratike, Misioni që nga fillimi ka qenë i involvuar në zhvillimin e mediave. Ai ka ndihmuar në themelimin e transmetuesit publik, Radio Televizionit të Kosovës (RTK), si dhe organet rregullative për mediat transmetuese dhe ato të shkruara. Misioni është tani duke i ndihmuar RTK-së të mbrojë autonominë e vet financiare dhe editoriale duke dhënë këshilla për dispozitat ligjore që do të sigurojnë zgjidhje të përhershme financiare. Misioni i OSBE-së gjithashtu promovon pavarësinë e organeve rregullatore të mediave dhe mbështet trajnimin e stafit të tyre.

Në sferën e shkollimit të lartë, Misioni është duke mbështetur universitetet publike në Prishtinë dhe Mitrovicë për t'u reformuar sipas agjendës evropiane të shkollimit të lartë të bazuar në Deklaratën e Bolonjës. Duke iu bashkëngjitur rrjetit evropian të universiteteve, ai u jep studentëve dhe stafit ligjërues lëvizshmëri dhe siguron njohjen e diplomave dhe qasje në shkollim kualitativ. Misioni ka ndihmuar themelimin e organeve që sigurojnë cilësi në universitete publike dhe ka siguruar infrastrukturë të teknologjisë.



Ruajtja e rendit dhe siguria publike

Një nga detyrat fillestare të Misionit të OSBE-së ka qenë themelimi i shkollës policore që do të trajnonte shërbimin shumetnik policor të Kosovës. Në vitin 2005, shkolla ka arritur standardin e caktuar prej 7,500 policë të diplomuar. Pasi që kualiteti i shkollës policore dhe i kapacitetit trajnues është shtuar, ajo gjithashtu filloi t'u ofrojë trajnime institucioneve tjera të sigurisë, siç janë doganat, shërbimet korrektuese si dhe shërbimet zjarrfikës dhe të shpëtimit.

Më 2006, shkolla u shndërrua në Qendrën Edukuese për Siguri Publike dhe Zhvillim e cila tani funksionon si institucion vendor. Misioni ende siguron mbështetje në zhvillimin e programeve të përbashkëta trajnuese për të gjitha institucionet e sigurisë publike me qëllim të përmirësimit të performancës së tyre të koordinuar sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Ajo gjithashtu siguron trajnim të specializuar për zyrtarë policorë dhe të doganave në luftimin e krimit të organizuar, siç është shpërlarja e parave, trafikimi me qenie njerëzore dhe kontrabandimi i drogës, automjeteve dhe mallrave të tjera.

Misioni ndihmon në ngritjen e vetëdijes për siguri publike përmes aktiviteteve në teren duke filluar nga ligjëratat në shkolla, ditët e hapura të policisë e deri te fushatat e informimit publik, që kanë për qëllim promovimin e punës dhe rolit të policisë dhe shërbimit zjarrfikës dhe të shpëtimit. Në nivel institucional, policia ka krijuar departamentin e policisë së komunitetit që koordinon angazhimet e policisë me publikun. Misioni gjithashtu mbështet punën e ekipeve vendore për siguri publike që i bashkon banorët vendorë, policinë dhe përfaqësuesit e komunës për t'i diskutuar brengat e tyre rreth sigurisë. Ekipeve të veprimit për siguri vendore kanë

implementuar projekte që kanë ngritur sigurinë dhe kanë përmirësuar kushtet e jetesës në shumë komuna. Ato kanë iniciuar për shembull diskutime shumetnike, kanë instaluar semaforë të rinj, kanë shënuar rrugëkalimet dhe kanë mbjellur drunjt që të zvogëlojnë ndotjen e ambientit.

Misioni gjithashtu ka ndihmuar në formimin e Inspektoratit të Policisë së Kosovës për të përmirësuar përgjegjësinë dhe për të forcuar besimin publik në punën e policisë. Inspektorati është një mekanizëm i kontrollit të brendshëm që heton ankesat kundër policisë. Është themeluar në vitin 2006 dhe tani Misioni monitoron dhe mbështet punën e tij.

Fakte dhe shifra

Nga 1 tetori i vitit 2008, Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë është Ambasadori Werner Almhofer nga Austria. Misioni ka tri departamente programore: Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, Departamenti për Demokratizim dhe Departamenti për Siguri dhe Rend Publik. Prezenca e Misionit në teren përfshinë 5 qendra rajonale: Gjilanin, Mitrovicën, Pejën, Prishtinën dhe Prizrenin si dhe 33 ekipe të qeverisjes komunale që mbulojnë të gjitha komunat e Kosovës. Buxheti për vitin 2009 është 26,910,000 Euro, si dhe numri i të punësuarve përfshinë 857 pozita: 224 ndërkombëtare dhe 633 vendore. Gati gjysma e stafit të Misionit punon në teren.

Mandati i Misionit, që buron nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 dhe Vendimi 305 i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së që nga 1 korriku 1999, i jep Misionit "një rol udhëheqës në çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve dhe demokracisë si dhe të drejtat e njeriut."

Zyra për Informim Publik

OSBE Misioni në Kosovë

Tel.: +381 38 240 100 lokali.1260

Mob.: +377 44 500 160

press.omik@osce.org

www.osce.org/kosovo

Organizata për Siguri dhe

Bashkëpunim në Evropë (OSBE)

punon për

stabilitet, prosperitet dhe demokraci

përmes dialogut politik për vlerat e

përbashkëta dhe përmes punës praktike për

rezultate afatgjata.